

ZERI I POPULLIT

ORGAN I KOMITETIT QENDROR TE PPSH

Viti 1 43-të i botimit
Nr. 89 (11.459)

E diel, 14 prill 1985

Çmimi 30 qindarka

MBLEDHJE E KOMITETIT QENDROR TE PARTISE PER TE NDERUAR KUJTIMIN DHE VEPREN E PAVDEKSHME TE SHOKUT ENVER HOXHA

Merret vendim për përjetësimin e emrit dhe të veprës së shokut Enver. Shoku Ramiz Alia zgjidhet Sekretar i Parë i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë.

KOMUNIKATE

MBI MBLEDHJEN E PLENUMIT TE 11-të TE KOMITETIT QENDROR TE PPSH

Për të nderuar dhe përjetësuar emrin dhe veprën e pavdekshme të udhëheqësit të lavdishëm të Partisë shokut Enver Hoxha, sot, më 13 prill 1985 u mbledh Plenumi i 11-të i Komitetit Qendror të PPSH.

Plenumi nderoi me dy minuta heshtje kujtimin e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të PPSH, shokut Enver Hoxha.

Në Plenum shoku Ramiz Alia foli për jetën dhe veprën e shkëlqyer të shokut Enver Hoxha si revolucionar e marksist-leninist i madh, që mbrojti me besnikëri dhe zhvilloi mësimet e Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit, si themelues, organizator e udhëheqës i Partisë, organizator e strateg i Luftës Nacionalçlirimtare e Revolucionit Po-

pullor, krijues e drejtues i pushtetit të diktaturës së proletarietit, arkitekt i ndërtimit të socializmit, themelues e Komandant i Përgjithshëm i Forcave tona të Armatosura, biri më i shtrenjtë dhe figura më e madhe historike e popullit dhe kombit tonë, që tërë jetën e Tij ia kushtoi Partisë, popullit, Atdheut, kauzës së komunizmit.

Për të përjetësuar emrin dhe veprën e shokut Enver Hoxha Plenumi mori vendimin përkatës.

Plenumi njëzëri zgjodhi Sekretar të Parë të Komitetit Qendror të PPSH shokun Ramiz Alia.

PLENUMI I 11-të I KOMITETIT QENDROR TE PARTISE SE PUNES TE SHQIPERISE
Tiranë, më 13.4.1985

VENDIM I PLENUMIT TE 11-të TE KOMITETIT QENDROR TE PPSH PER PERJETESIMIN E EMRIT DHE VEPRES SE SHOKUT ENVER HOXHA

Plenumi i 11-të i Komitetit Qendror të PPSH, i mbledhur më datën 13 prill 1985, për të përjetësuar emrin dhe veprën e shokut Enver Hoxha, Sekretar i Parë i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, Kryetar i Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik të Shqipërisë, Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, udhëheqës i madh e i lavdishëm i Partisë dhe i popullit tonë,

Vendosi:

1. - Të ngrihet Përmendorja e shokut Enver Hoxha në kryeqytetin e Atdheut, Tiranë, në vendlindjen e Tij, në Gjirokastër dhe në qytetin e Korçës.
2. - Universiteti i Tiranës të marrë emrin «Universiteti i Tiranës Enver Hoxha».

versiteti i Tiranës Enver Hoxha».

3. - Organizata e Pionierit të marrë emrin «Pionierët e Enverit».

4. - Porti Detar i Durrësit të marrë emrin «Porti Detar i Durrësit Enver Hoxha».

5. - Ndërmarrja Bujqësore me qendër në Plasë të rrethit të Korçës të marrë emrin «Ndërmarrja Bujqësore Enver Hoxha».

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Këshilli i Ministrave të RPSSH.

PLENUMI I 11-të I KOMITETIT QENDROR TE PARTISE SE PUNES TE SHQIPERISE

Tiranë, 13 prill 1985

VENDIM I PLENUMIT TE 11-të TE KOMITETIT QENDROR TE PPSH PER ZGJEDHJEN E SEKRETARIT TE PARE TE KOMITETIT QENDROR TE PPSH

Plenumi i 11-të i Komitetit Qendror të PPSH, i mbledhur më 13 prill 1985, me propozimin e Byrosë Politike të KQ të PPSH njëzëri

Vendosi:

Të zgjedhi Sekretar të Parë të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë shokun Ramiz Alia,

anëtar i Byrosë Politike dhe Sekretar i Komitetit Qendror të PPSH.

PLENUMI I 11-të I KOMITETIT QENDROR TE PARTISE SE PUNES TE SHQIPERISE

Tiranë, 13 prill 1985

NJE JETE, NJE EPOKE

Betimi i popullit

Udhëheqësi ynë i shtrenjtë, i dashuri ynë i madh, i lavdishmi Enver Hoxha, që u thinj në istikame si majat e Alpeve të rënuara nga dimri i jashtëzakonshëm i këtij viti, gojëmjafti e fjalëshpata, e shkriu jetën e Vet për popullin. Për ne! Për Partinë. Shokë, vëllezër, komunistë,

mbajeni veten fort siç na donte shoku Enver. «Zemrat lart!» - Siç na mësonte Ai. Jepuni kurajo nënave dhe motrave, grave e vajzave, fëmijëve që të këputin shpirtin me fjalët e tyre, rinisë që është veshur kuq e zi, punëtorëve që kthehen nga puna për të dytën ditë me bukën e pangrënë të mëngjesëve. Shtrohen e ngrihen tryezat e një

kafshatë bukë s'futet në gojë. Mbahuni të fortë se shoku Enver rron. Ai është i gjallë, në jetë e në revolucion. Shihen dorën e Tij, tek na tregon të ardhmen. Drita e syve të Tij të qeshur mbush hapësirën e kësaj dite pranvere. Mos e besoni kurrë se zemra e Tij ka pushuar së rrahuri. Ai rron në (Vijon në faqen 2)

Rroftë vepra dhe kujtimi i mësuesit dhe Udhëheqësit tonë, shokut Enver Hoxha!

DJE NE PLENUMIN E 11-të TE KOMITETIT QENDROR TE PARTISE

Dje u mbajt në Tiranë Plenumi i 11-të i Komitetit Qendror të PPSH për të nderuar e përjetësuar emrin dhe veprën e pavdekshme të udhëheqësit të lavdishëm të Partisë shokut Enver Hoxha.

Në Plenum mbajti një fjalim të rëndësishëm shoku Ramiz Alia për jetën dhe veprën e shkëlqyer të shokut Enver Hoxha.

Plenumi nderoi me dy minuta heshtje kujtimin e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të PPSH shokut Enver Hoxha.

Për të përjetësuar emrin dhe veprën e shokut Enver Hoxha Plenumi mori vendimet përkatëse.

Pastaj në emër të Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë e mori fjalën në plenum anëtar i Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë shoku Adil Çarçani, i cili propozoi që në detyrën e lartë të Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të Partisë të zgjedhin shokun Ramiz Alia, të cilin shoku Enver me të drejtë e ka cilësuar

një nga bashkëluftëtarët e tij më të shquar.

Në fjalën e tij shoku Adil Çarçani foli për jetën dhe veprimtarinë politike e revolucionare të shokut Ramiz Alia si një ndër komunistët, partizanët e kuadrot e Luftës Nacionalçlirimtare, si një ndër kuadrot me përgjegjësi të Rinisë Komuniste Antifashiste shqiptare, si anëtar i Komitetit Qendror të Partisë që nga Kongresi i parë. Ai tha se shoku Ramiz Alia në të gjitha detyrat me shumë përgjegjësi që i janë ngarkuar ka luftuar e punuar me besnikëri të lartë si nxënës e bashkëluftëtar i ngushtë i shokut Enver Hoxha.

Duke shprehur mendimin unanimit të Byrosë Politike, tha duke përfunduar shoku Adil Çarçani, jam i bindur se shpreh edhe mendimin e të gjithë shokëve e shoqeve të plenumit, të të gjithë Partisë dhe popullit se Komiteti Qendror i Partisë duke e kthyer dhimbjen në forcë dhe duke zbatuar me besnikëri vijën e përgjithshme të Partisë dhe mës-

met e shokut Enver Hoxha me shokun Ramiz Alia si Sekretar të Parë, do ta vazhdojë e do ta çojë gjithnjë përpara veprën e lavdishme të Partisë e të shokut Enver, do të punojë me të gjitha forcat e unitet të plotë marksist-leninist për ta forcuar pa rreshtur Partinë dhe gjithë sistemin e diktaturës së proletarietit në vendin tonë, do ta mbajë lart shpatën e mprehtë të shokut Enver kundër të gjithë armiqve të jashtëm e të brendshëm të vendit tonë.

Plenumi i 11-të i Komitetit Qendror të Partisë miratoi njëzëri propozimin e Byrosë Politike që në detyrën e lartë të Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të Partisë të jetë shoku Ramiz Alia.

Pastaj anëtarët e Plenumit të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë shkuan në sallën e Presidiumit të Kuvendit Popullor dhe bënë homazhe dhe roje nderi pranë arkivolit me trupin e theme-

(Vijon në faqen 2)



Shoku Ramiz Alia, të cilin Plenumi i 11-të i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, e zgjodhi me unanimitet të plotë Sekretar të Parë të Komitetit Qendror të Partisë, siç e ka cilësuar vetë shoku Enver Hoxha, është një nga bashkëluftëtarët e tij më të shquar si gjatë Luftës Nacionalçlirimtare ashtu edhe në epokën e ndërtimit të socializmit në Shqipëri.

Shoku Ramiz Alia lindi në vitin 1925 në qytetin e Shkodrës, në një familje të varfër.

Qysh kur ishte nxënës në Liceun e Tiranës mori pjesë aktive në Lëvizjen Antifashiste Nacionalçlirimtare, si anëtar i organizatës së Rinisë Komuniste që me themelimin e saj.

Në fillim të vitit 1943 pranohet anëtar i Partisë Komuniste Shqiptare (sot Partia e Punës e Shqipërisë). Gjatë luftës për çlirim kombëtar nga zgjedha e nazifashizmit, Partia e ngarkoi shokun Ramiz Alia me përgjegjësi të rëndësishme në udhëheqje të organizatës së Rinisë Komuniste.

Më pas, në moshën 19-vjeçare atij iu besuan detyra me përgjegjësi politike e ushtarake në drejtimin e Brigadës së 7-të Sulmuese partizane, në divizionin e dytë dhe komisar i divizionit të pestë të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare, i cili me urdhërin e Komandantit të Përgjithshëm të Ushtrisë partizane Nacionalçlirimtare, shokut Enver Hoxha, luftoi kundër fashizmit edhe në tokat e Jugosllavisë.

Në gusht të vitit 1944 në Kongresin e parë të Rinisë Antifashiste Shqiptare, shoku Ramiz Alia u zgjodh anëtar i Sekretariatit të Rinisë dhe më pas, në nëntor 1948, Sekretar i parë i Komitetit Qendror të Bashkimit të Rinisë së Punës të Shqipërisë.

Që nga Kongresi i parë i Partisë në nëntor 1948 dhe vazhdimisht, shoku Ramiz Alia është zgjedhur anëtar i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë. Në Kongresin e tretë të Partisë, në maj 1956,

ai u zgjodh kandidat i Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë. Që nga Kongresi i katërt i Partisë, shkurt 1961, është zgjedhur anëtar i Byrosë Politike dhe Sekretar i Komitetit Qendror të Partisë.

Shoku Ramiz Alia bashkëluftëtar dhe bashkëpunëtor i afërt i shokut Enver Hoxha, është personalitet i shquar politik e shoqëror dhe burrë shteti. Ai është zgjedhur deputet në Kuvendin Popullor që nga legjislatura e dytë e vazhdimisht. Ka qenë Ministër i Arsimit dhe i Kulturës, është zëvendëskryetar i Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik të Shqipërisë. Në legjislaturën e 10-të të Kuvendit Popullor, shoku Ramiz Alia është zgjedhur Kryetar i Presidiumit të Kuvendit Popullor të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

Në të gjitha detyrat me përgjegjësi të lartë Partie, shtetërore e shoqërore, që i janë ngarkuar, ai ka luftuar e punuar me besnikëri e vendosmëri shembullore për forcimin e Partisë, për edukimin e komunistëve e të punonjësve me ideologjinë Marksiste-Leniniste.

Përkrah shokut Enver Hoxha, shoku Ramiz Alia ka luftuar me konsekuencë dhe frymë internacionaliste të patundur për mbrojtjen e Marksizëm-Leninizmit dhe të vijës së Partisë kundër revizionizmit jugosllav, sovjetik e të gjitha ngjyrave. Ai ka zhvilluar me principialitet të lartë luftën e klasave.

Shoku Ramiz Alia është luftëtar konsekuent për mbrojtjen e lirisë e të pavarësisë së vendit, për mbrojtjen e fitoreve të revolucionit kundër imperializmit e socialimperializmit dhe shërbëtorëve të tyre brenda dhe jashtë vendit. Ai ka mbrojtur e zbatuar me aftësi e pjekuri të lartë politikën e jashtme parimore, revolucionare e paqedashëse të Partisë e të Shtetit tonë.

DJE NE PLENUMIN E 11-të TE KOMITETIT QENDROR TE PARTISE

(Vijon nga faqja 1)

luesit të Partisë sonë, arkitektit të ndërtimit të Shqipërisë së re socialiste, shokut Enver Hoxha.

Në shenjë nderimi e respekti të thellë për veprën e ndritur e të pavdekshme të udhëheqësit të dashur e të lavdishëm të Partisë e të popullit tonë, shokut Enver Hoxha, ata qëndruan në heshtje.

Në këto çaste solemne dhe të dhimbshme së thellë, shoku Ramiz Alia tha:

«Shokë,

Gjithnjë jemi mësuar t'i raportojmë shokut Enver çdo punë që bëjmë. Sot kemi ardhur këtu dhe dua që gjithë plenumi i Komitetit Qendror t'i themi shokut Enver, të betohemi përpara Tij se të gjithë ne anëtarët e Komitetit Qendror, tërë Partia jonë, tërë populli ynë do të ecim në rrugën e Enverit, sipas mësimave të Tij. Të betohemi se do të çojmë përpara veprën e madhe që ka krijuar Enver Hoxha.

Prandaj të tërë njëzëri të themi:

«Betohe mi!»

Betohe mi! - përgjigjen njëzëri të gjithë anëtarët e Plenumit.

Pastaj udhëheqësit të Partisë e të shtetit përlulen me respekt e mirënjohje të thellë para arkivolit me trupin e shokut Enver Hoxha, figurës më të madhe historike të popullit dhe kombit tonë, dhe nderojnë me grushtin lart.

Me kaq u mbyllën punimet e plenumit të 11-të të KQ të PPSH-së.

(ATSH)

NJE JETE, NJE EPOKE

(Vijon nga faqja 1)

çdo familje, është në çdo betejë që ne vazhdojmë e do të nisim sërish...

Të gjitha këto janë fjalë të mblodhura një e nga një, që herët në mëngjes në stacionet e autobusëve, pranë tornove e vatrave familjare, në sheshin «Skënderbe» e në shtetitoren «Dëshmorët e Kombit», ku vargu i njerëzve çdo çast zgjatet e zgjatet.

Si po e nxë Tirana gjithë këtë dhimbje? Futemi në shtëpinë që ka më shumë fëmijë se çdo tjetër në Tiranë e në të gjithë Shqipërinë: në shtëpinë e fëmijës «8 Nëntori». Ngashërimi i fëmijëve të këput zemër, të lagët xhaketa nga lotët e nxehtë. Ata të rrethojnë tërë ngashërima e dënësia, e ti mbaje po deshe, mbaje buzën e mjekrën mos të të dridhet.

U mblodhën grusht rreth shokut, rreth shoqes, - na flet nxënësi Elena Biba, - nuk dimin ç'të bënim. I lamë portretet e shokut Enver me lotë. U mbushën dërrasat e zezë me betime: «Motra dhe vëllezëri! Vdekja na rrëmbeu xhakshin Enver, Udhëheqësin dhe mësuesin tonë të dashur. Se sa e madhe është kjo humbje e dinë vetëm zemrat tona të vogla, që ngashërehen e s'ngopen duke qarë. Betohe mi, o xhakshi Enver, se Shqipërinë do ta ruajmë të kuqe, ashtu siç e le dhe e doje Ti».

Ndërkohë ora ka shkuar 9.00. Hyjnë të parët nga vargu i gjatë prej dhjetëra mijë vetësh e nderojnë me grusht.

Papritur, lëvizja ndërpritet. Mpihet gjithçka. Pranë arkivolit vijnë: bashkëshortja e bashkëluftëtarja e shokut Enver shoqja Nexhmije Hoxha. Vijnë fëmijët. Vijnë motrat. Të afërmit. Cili shtatë të nxuri e nuk flet më, o shoku Enver! Buza u dridhet. Sytë kanë lotët e dhimbjes më të madhe. Vdekje, o vdekje e hidhur. Shoqja Nexhmije Hoxha prek me dorë të dridhur arkivolin dhe vendos mbi të një buqetë me lule, me mbishkrimin:

«Shtatë lule të kuqe lamtumirë për gjyshin tonë të shtrenjtë e të paharruar. Valbona, Ermali, Dritan, Shpati, Shkëlzen, Blerina, Besmiri.

Tiranë, 12.4.1985».

Populli betohe: Në rrugën e lavdishme që projektovet Ti shoku Enver, do të marshojmë, duke qarë bilokada e rrethime drejt socializmit.

C'që kjo që ndodhi o Enver! - flet duke u dridhur veterani Esat Dishnica, shoku i Tij i Luftës, i illegalitetit të rëndë. - Ato që më the në rini, i bëre të gjitha. Populli do të të jetë mirënjohës tërë jetën, prandaj edhe qan për Ty si çilimi.

Betohe mi. Dhjetë mijë studentë të Universitetit kanë shkruar betimin më të njëjtat fjalë «Parti, Enver, jemi gati kurdoherë». Ky është betimi i popullit.

«Mbajeni Shqipërinë»

Midis mijëra e mijëra njerëzve që vijnë e bëjnë homazhe e që dalin nga selia e Presidiumit duke qarë me dënësë është edhe pensionisti Serjan Rrokaj. Rrimë pak sa ai mbledh veten.

Me të dalë nga mbledhja e organizatës-bazë të Partisë, u nisa për në Tiranë. Jam i tronditur pa masë, bir. Erdha se këtu në Tiranë kam të dy fëmijët. Erdha t'u bëj kurajo se janë të rinj e të pavarur me halle të mëdha. Ra mali me kurorë, bir. Djemtë më bëjnë mua kurajo. Unë u thashë atyre: Mbajeni Shqipërinë. Ata më morën në qafë, më vunë kokën në gjokë. Rinia lindi, u rrit, u bë 40-vjeçare, u mësua me Enver Hoxhën e sot. Hapu dhe e më merr!

Vështirë të gjendet në botë një vend i vogël si Shqipëria jonë, - shkruante shoku Enver në Përsëhëndetjen me rastin e 40-vjetorit të

Çlirimit të vendit, - me një popull të tillë si populli shqiptar, që të ketë luftuar kaq shumë, që të ketë treguar kaq shumë trimëri e mençuri, e t'i ketë thyer të gjithë armiqtë dhe të ketë dalë kryelartë përpara historisë».

Në këtë rrugë e udhëhoqi Partia me shokun Enver në krye. Ai nuk është mes nesh. Partia rron e do të rrojë sa populli, i cili brez pas brezi, ka lënë e do të lërë një amanet: Mos iu ndani rrugës së Partisë, rrugës së Enver Hoxhës!

Dhjetëra e qindra veteranë të luftës të shokut Enver, miq të familjes së Tij, punëtorë, fshatarë, intelektualë e ushtarakë që i ka takuar Ai në vise të ndryshme të Atdheut, që kanë shkruar të njëjtëtri, që kanë shkëmbyer letra e telegrame për raste gëzimi e hidhërimi, takohen këtu në selinë e Presidiumit të Kuvendit Popullor me shogun Nexhmije Hoxha, me fëmijët, motrat, të afërmit, e u shprehin atyre ngushëllimet për humbjen e njeriut të tyre më të dashur, Udhëheqësit të lavdishëm të popullit e të Partisë, shokut Enver Hoxha.

Vjen në këtë sallë, duke u dridhur prej emocionit të dhimbjes së madhe edhe nënë Shaho Luçi, që ka zbritur në kryeqytet këto ditë zie nga Kuçi i largët malor. I ka kaluar të 80-tat. Është nëna e Heroit të Popullit Nuri Luçi dhe e dëshmorit Jashar Luçi.

Ngushëllime, të mbahesh e fortë! Të na rrojë Partia! - i drejtohet nëna shoqes Nexhmije Hoxha.

Ju kini dhënë shembullin më parë se si duhet qëndruar, se ju janë vlarë dy djemtë. Të cilët gjakun e tyre e hodhën në themelet e Shqipërisë së sotme, - përgjigjet shoqja Nexhmije Hoxha.

Nënë Shahoja ka dhimbje të madhe, si të gjitha nënat. Kur zemra dhemb fjalët mezi dalin, por ato janë të kristalta, se dalin nga shpirti. «Shkoj Trim përpara, vështirësitë i çau, përpara shkoj gjithnjë, - thotë nëna. - Ç'tha dhe ç'nuk bëri Enver. Veprat e tij janë të pavdekura. Edhe unë, me mësimet e shokut Enver, i dërgova djemtë në luftë, u dhashë gjerdanë dhe u thashë që të mos qëndrojnë as në fund e as në mes, por në ballë».

Enveri do të vejë tek djemtë e tu, - thotë shoqja Nexhmije Hoxha. - T'i shikojë, t'i takojë e të çmallet me ta.

Se mos vetëm tek ata, - vazhdon nëna, - por tek të gjithë shokët që luftuan e ranë për çlirimin e vendit dhe për Partinë.

Njeriu vdes, por Partia nuk vdes kurrë, populli nuk vdes kurrë, thosh Enveri, - kujton shoqja Nexhmije Hoxha.

Ç'do të moshuari do t'i binte pika, po të mos jetonte ditët e Enver Hoxhës, - thotë me lot në sy shoku Shefqet Peçi. - Kur i thoshe «Të na rrosh sa malet, shoku Enver!» Ai përgjigjej: «Të na rrojë Partia!». Këtë dhimbje të madhe do ta kthejmë në forcë, të mobilizohemi të reagojmë gjithë detyrat e planet se kemi Partinë, e kemi të fortë, na e la të pastër shoku Enver.

Ashtu është, - thotë shoqja Nexhmije Hoxha. - Partinë e kemi të fortë, e kemi në duar të sigurt. Shoku Enver gjithë jetën luftoi e punoi për forcimin e unitetit të Partisë me popullin. Dua të them se kemi një rini të pastër, e cila në këto ditë të dhimbshme shfaqti dashurinë e madhe që ka për shokun Enver. Këtë dashuri e tregoi me përmasa të mëdha këto ditë, ku nuk e përmbajti hidhërimin.

Më i çeliktë është bërë uniteti pas çdo ngjarjeje të madhe kombëtare. Këtë frymë patriotizmi e atdhedashurie futi në popull Partia dhe shoku Enver. Kjo është jellë e shtë e papshtueshme.

Nënë Shahua i hedh duart në qafë shokut Ramiz Alia dhe i thotë:

- Na iku Enveri! Të na rrojë Partia! Tani do ta mbani ju Shqipërinë, na e la hazër Enveri.

Brezat bëjnë betimin para njëritjetrit.

Pena që tregoi rrugën e së ardhmes

Shfletoni albumin fotografik që u botua me rastin e 75-vjetorit të ditëlindjes së shokut Enver Hoxha. Midis shumë fotove që u takojnë kohëve, ngjarjeve, viseve të ndryshme të Atdheut, është dhe ajo e Komandantit me ushtarakun Thanas Moça. E takojmë Thanasin këtu në sallën e selisë së Presidiumit të Kuvendit Popullor. Ai na tregon:

Ishte mars i vitit 1970. Koha ishte e bukur. Komandanti erdhi në Pallatin e Brigadave. I raportova, më përqafoi... Në shtëpi kam ditarin e bisedës së asaj dite që zgjati plot tre orë e çysmë. Po ditari më i mirë është zemra.

Dëgjoni bisedën e bashkëfolësit e thua i menduar: Ç'jetë intensive ka bërë shoku Enver! Në themel të zhvillimit politik e ideologjik, ekonomik e kulturor, shkencor e ushtarak, letrar e artistik është mendimi i Tij i thellë shkencor, logjika e Tij e hekurt, dëshira e zjarrtë për të vënë në shërbim të popullit gjithë potencialin e Tij intelektual të mahnitshëm, energjitë fizike të pashtershme prej titani. Ç'takime të shpeshta me njerëzit e thjeshtë! Me cilën nënë dëshmorin nuk është takuar apo nuk ka dalë në fotografi? Me cilët ish-partizanë të batalioneve e brigadave partizane nuk shkëmbeu dialogë për më shumë se 40 vjet me radhë? Me sa e sa shkrimtarë e artistë ka zhvilluar biseda e kujt nuk ia ka lexuar krijimet? E cilin njeri të përparuar të kohës sonë Ai nuk e takoi në mbledhje, në vizita, në takime?


Kur po bisedonim, - vazhdon Thanasi, - shoku Enver pa një ushtar me historinë e Partisë në dorë. I tregova se pas pak do të mblidhehim të diskutonim rreth temës: «Ndërrhyrjet e tititëve në punët e brendshme të Partisë e të popullit tonë». A do të më lejoni, më tha shoku Enver, t'u shpjegoj edhe unë diçka?

Në mendimin e Tij hartoheshin veprat madhore: «Titistët», «Hrushovianët», «Rreziku anglo-amerikan për Shqipërinë», «Imperializmi dhe revolucioni». Pena e Tij i ka dhënë popullit më shumë dritë se gjithë hidrocentralet e mëdhenj që kemi ngritur.

Ne ndërtuesit, çdo tullë e gur të qyteteve e kemi peshuar në duar, - na tha Heroi i Punës Socialiste Kujtim Demollari. - Kështu si ne shoku Enver «ka peshuar» gjithçka që përbën kalanë shqiptare. Ne ndërtuesit përdorim plumbin për të ngritur mure të drejta, të forta. Partia, shoku Enver, kanë përdorur vetëm marksizëm-leninizmin. Dhjetëra mijë njerëz të tjerë sot u përlulen me mirënjohje të pakufishme përpara arkivolit ku prehet i pavdekshmi Bir i Shqipërisë - Enver Hoxha! Vatrave shqiptare s'do t'u mungojë kurrë më i miri, më i dashuri, më i shtrenjti. Flokëthinjuri, tipografë, që radhitën artikujt e parë të Tij, i përzien shkronjat e njoftimit të hidhur me ngulçe, dënësia, ngashërima. Jo, Enver Hoxha nuk është ndarë prej jush! Kombinatat poligrafike s'do të mbarojnë kurrë së botuari mendimin e Tij. Zemra hesht, po vepra flet. Populli s'mund të rrijë pa kuvenduar me të. Mendimi i Enverit do të drejtojë epokat.

PËRPARIM XHIXHA
SHABAN SINANI

Tiranë, më 13 prill 1985



VEPRA E SHOKUT ENVER DO TE MBETET NE SHEKUJ FLAMUR PUNE E LUFTË

- NGA LETRAT DHE TELEGRAMET E DERGUARA KO TE PARTISE -

Komunistët e punëtorët e kombinitatit të Autotraktorëve «Enver Hoxha» në telegramin e tyre, ndër të tjera, shkruajnë: Kujtojmë me mallëngjim ato çaste që të lumtura që kanë krijuar vizitat e shokut Enver në kolektivin tonë, gëzimin e papërkshkruar që ndriste në fytyrat e punëtorëve, takimet dhe përqafimet e udhëheqësit tonë të shtrenjtë fjalët dhe këshillat e tij të urta, që burojnë si mjalte nga goja e tij dhe që mbushnin njerëzit me gëzim e optimizëm për jetën, për punën, për të ardhmen e bukur e të lumtur që ndërton populli ynë nën udhëheqjen e Partisë. Vepra e shokut Enver do të mbetet në shekuj flamur pune e lufte, udhëheqje për veprimet revolucionare, për ta bërë atdheun tonë të dashur më të fuqishëm e më të begatë.

Duke zbatuar porositë që na jep Partia në këto çaste të dhimbshme, zotohemi se do të realizojmë planin vjetor të prodhimit të përgjithshëm industrial 5 ditë para afatit.

Na hidhëroi thellë në zemrat tona vdekja e shokut Enver Hoxha, sepse jeta dhe vepra e tij janë të pandara me të gjitha fitoret historike të popullit tonë, shkruajnë komunistët dhe punëtorët e ndërmarrjes bujqësore në rrethin e Gramshit. Për ne, vazhdojnë ata, shoku Enver nuk ka vdekur dhe nuk do të vdesë kurrë. Mësimet dhe vepra e tij na udhëheqin e do të na udhëheqin në çdo kohë.

Ne shkruajnë gratë dhe të rejtat e kooperativës bujqësore Heroinë e Punës Socialiste të Këmishtajt, ashtu si gjithë gratë e Shqipërisë, Partia dhe shoku Enver na nxorën nga injoranca e padija në ditë, nga shtypja e skllavërimi, në jetë, në prodhim e në drejtim të jetës politike e shoqërore. Shoku Enver 10 vjet më parë na dërgoi letër ku na përgëzonte për rezultatet në bujqësi e blegtori. Porositë e tij ne do t'i kemi busull orientimi për ta çuar më përpara bujqësinë tonë socialiste.

Ne, shkruajnë veteranët e fshatit Labinot-Mal, u prekëm rëndë në zemër e shpirt kur mësua se pushoi së rrahuri zemra e udhëheqësit tonë të dashur, besnikut më të sprovuar të Partisë shokut Enver Hoxha. Në ditët e vështira, kur Partia organizoi punimet e Konferencës së parë të vendit të PKSH, for-

mimit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë dhe Konferencës së Dytë Nacionalçlirimtare në Labinot, ne veteranët e Labinot-Malit kryem shërbime të rëndësishme sipas porositë të shokut Enver. Duke kujtuar këto data historike vlerësojmë punën e madhe organizuese e mobilizuese të udhëheqësit tonë të shtrenjtë të shokut Enver Hoxha, i cili na brumosi me ideat e larta të Partisë dhe të revolucionit.

Duke patur në mendje dhe zemër mësimet e Partisë e të shokut Enver thonë kooperativistët e Frakullës së madhe, do të luftojmë që detyrat e vitit 1985 t'i bëjmë realitet. Do të forcojmë pa rreshtur unitetin tonë monolit dhe do të ngremë më lart vigjilencën revolucionare.

Ndërsa kolektivtë mësues nxënësi shkollës së mesme bujqësore «Nazmi Rushiti» në Peshkopë në telegramin e tij ndër të tjera shkruan: Shoku Enver Hoxha, si figura më e madhe historike e popullit dhe e kombit tonë, do të jetë shembull i pavdekshëm në rrugën e shkollës sonë për dije e kulturë dhe mësimet e tij do të na ndriçojnë në shkëlqim të pashuar jo vetëm ne por gjithë brezat e ardhshëm. Ne jemi bijtë e atyre mësuesorëve që dje edhe pse jetojnim në terr, portat e Korabit, Qafën e Skertecit apo Grykën e Dritit kurrë s'i lanë hapur. Me emrin e Partisë dhe të Atdheut ata kanë qëndruar gjithnjë në llogore. Rrugën e tyre ne e kemi ndjekur e do ta ndjekim brez pas brezi.

Ashtu si për të gjithë rininë tonë heroike, edhe për ne shkruajnë të rinjtë minoritarë të Partizanit malor në rrethin e Sarandës, shoku Enver ka qenë gjithmonë pranë me mësimet dhe porositë e tij. Në këto ditë të hidhërimi të thellë ne betohe mi para Partisë, se dhimbjen do ta kthejmë në forcë për të realizuar të gjitha detyrat. Parulla e Partisë «Punë dhe vigjilencë» ka qenë dhe mbetet motua jonë.

Ne, shkruajnë punonjësit e Ministrisë së Punëve të Jashtme kemi ndërjet çdo ditë nga afër kujdesin dhe veprimtarinë udhëheqëse të shokut Enver, si themelues i politikës së jashtme të pavarur, parimore e të hapur të shtetit tonë socialist, si frymëzues i qëndrimeve të vendosura e të guximshme të

Partisë e të vendit tonë kundër imperializmit, socialimperializmit dhe reaksionit, në përkrahje të luftës së drejtë të popujve për çlirim kombëtar e shoqëror. Udhëheqësi ynë i dashur nuk ka vdekur. Ai rron në zemrat tona.

Megjithëse të moshuar, nuk do të kursejmë asgjë për interesat e Partisë, të popullit e të socializmit, shkruajnë veteranët dhe pensionistët e Lagjes Nr. 4 të Kryeqytetit. Edhe jetën tonë po ta dojë nevoja do ta japim për të zbatuar dhe mbrojtur vijën e Partisë sonë të lavdishme, mësimet e pavdekshme të shokut Enver Hoxha. Betohe mi se do të jemi gjer në fund me Partinë tonë të shtrenjtë.

Shoku Enver Hoxha, shkruajnë në telegramin e tyre anëtarët e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve të Shqipërisë, ka qenë dhe do të mbetet kurdoherë në zemrat tona udhëheqës, shok dhe mësues i madh i shkrimtarëve e artistëve. Me këshillat e urta e shoqërore, me orientimet dhe analizat shkencore marksiste-leniniste, me inkurajimin dhe fjalën e ëmbël që buronte nga një zemër e madhe, ai ishte dhe do të mbetet gjithmonë pranë nesh, në frymëzimet e reja, në punën tonë të përditshme.

Shoku Enver, shkruajnë ndër të tjera gardistët, do të mbetet edhe për ne gjithmonë jo vetëm Komandant, por edhe mësues i madh, sepse na ka qëndruar gjithnjë pranë, në çdo kohë e situatë. Mësimet dhe porositë e Tij kanë qenë e do të jenë burim frymëzimi e mobilizimi për të mprehur vazhdimisht vigjilencën e për të forcuar gatishmërinë luftarakë, për të përmbushur me sukses të gjitha detyrat që na ka ngarkuar Partia.

Humbjen dhe hidhërimin do t'i kthejmë në forcë, duke pasur bazë Veprat dhe mësimet e shokut Enver, duke ruajtur si gjënë më të shtrenjtë Partinë dhe unitetin e saj, shkruajnë në telegramin e tyre efektivtë i shkollës së lartë të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Për të mbrojtur fitoret tona, pushtetin tonë popullor nuk do të kursejmë as pikën e fundit të gjakut tonë.

(ATSH)

Shqipëria nderon me respekt të thellë kujtimin e shokut Enver Hoxha

Qindra mijëra vetë në të katër anët e vendit po marrin pjesë në mitingjet e organizuara për të nderuar jetën dhe veprën e pavdekshme të Udhëheqësit të dashur të Partisë e të popullit shokut Enver Hoxha. Kudo po shprehet hidhërimi i madh dhe i thellë për vdekjen e Udhëheqësit të shtrenjtë. Masat punonjëse po shprehin gjithashtu vendosmërinë e patundur që, duke e kthyer dhimbjen në forcë të zbatojnë me vendosmëri mësimet e shokut Enver në rrugën e ndërtimit të socializmit.

Më se 100 000 banorë të rrethit të Durrësit morën pjesë në mitingje që janë organizuar në qendra të ndryshme. Në sheshin kryesor të qytetit të Kavajës u mblodhën punonjësit të pararojës të fabrikës së qelqit, të uzinës së gozhdë bulonave e të qendrave të tjera të punës e të prodhimit. Mbi figurën e ndritur të udhëheqësit të dashur të Partisë e të popullit shokut Enver Hoxha,

foli sekretari i Komitetit të Partisë të rrethit Mehmet Karakushi.

Qindra kooperativistë të Konispolit në rrethin e Sarandës, kufitarë e ndërtues të ujëmbledhës të Janjarit u mblodhën në sheshin kryesor të qytetit për të nderuar kujtimin dhe veprën e shokut Enver Hoxha.

Për figurën e ndritur e të pavdekshme të shokut Enver Hoxha, me

emrin e të cilit janë të lidhura të gjitha fitoret e Partisë e të popullit tonë, foli sekretari i Komitetit të Partisë të rrethit Halim Pashuni. Kooperativistë e kufitarë që e morën fjalën shprehën hidhërimin e thellë dhe vendosmërinë se do të jenë kurdoherë në ballë për begatimin me tej të ekonomisë së tyre dhe mbrojtjen e Atdheut.

Në lagjen Palortro të qytetit të Gjirokastër, është shtëpia ku lindi shoku Enver Hoxha, biri më i shtrenjtë i Gjirokastër dhe i gjithë Shqipërisë. Këto ditë zije për mbarrë vendin ajo pret e përcjell ane-

(Vijon në faqen 4)

MIRENJOHJA E MADHE E PARTISE DHE E POPULLIT

NGA FJALA E SHOKUT RAMIZ ALIA NE PLENUMIN E 11-të TE KOMITETIT QENDROR

Historia e popullit tonë ka njohur shumë njerëz të shquar, tha midis të tjerash, shoku Ramiz Alia, shumë luftëtarë e patriotë të vërtetë, që kanë dhënë një kontribut të madh për lartësimin e kombit dhe përparimin e vendit, për lirinë dhe pavarësinë e Atdheut. Shoku Enver Hoxha zë vendin kryesor, si figura më e madhe historike e kombit shqiptar.

Njerëz si Enver Hoxha janë të rrallë në historinë e popujve, ata janë gjigandë të mendimit e të veprimit që i linden revolucionet e mëdha, ata bëjnë epokë. Me të drejtë populli ynë kohën që jetojmë sot e quan koha e Partisë. Kësaj kohe, me veprën e vet të shquar e të gjithanshme shoku Enver i ka dhënë edhe emrin e tij.

Shoku Enver është themeluesi i Partisë sonë të lavdishme, i organizatorës së të gjitha fitoreve të popullit tonë. Ai duke qenë në krye të Partisë që nga themelimi e vazhdimisht e forcoi atë organizativisht dhe e kaliti ideologjikisht, e bëri atë të aftë që t'i bënte ballë me sukses detyrave të mëdha historike që shtriheshin përpara saj. Shoku Enver e bëri Partinë një Parti proletare të tipit leninist, të vendosur e të guximshme, luftarake dhe të paepur për interesat e popullit. Shoku Enver e bëri Partinë një forcë të pamposhtur revolucionare që diti të udhëheqë popullin nga fitorja në fitore, si në luftën për çlirim, ashtu edhe në ndërtimin socialist të vendit.

Erënjët e Shqipërisë së re janë te lufta e lavdishme Nacionalçlirimtare. Shoku Enver Hoxha është organizatori dhe udhëheqësi heroik i Luftës Nacionalçlirimtare dhe i revolucionit tonë popullor. Ai gjeti dhe përcaktoi rrugët e organizimit dhe të zhvillimit të saj në mënyrë që ta çonte popullin me siguri në fitoren përfundimtare.

Shoku Enver, tha më poshtë shoku Ramiz Alia, qysh në kohën e Luftës i dha popullit dy armë kryesore për fitoren mbi armiqtë, dy instrumente të revolucionit që vazhdojnë edhe sot të jenë armë të fuqishme në luftën për socializmin dhe mbrojtjen e Atdheut. Si marksist i vërtetë dhe si strateg i madh shoku Enver, e kishte të qartë se populli nuk mund të fitonte, se liria nuk mund të sigurohej pa krijuar forcën e organizuar politike, dhe atë ushtarake të Lëvizjes. Prandaj, ai punoi me të gjitha forcat, si komunist dhe patriot i zjarrtë për krijimin e Frontit Nacionalçlirimtar, ku do të bashkoheshin të gjithë shqiptarët, të cilëve u dhimbesh liria dhe pavarësia.

Shoku Enver është organizatori i Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Ai si Komandant i Përgjithshëm e ka udhëhequr atë në të gjitha betejat vendimtare. Lufta jonë në sajë të udhëheqjes së Shtabit të Përgjithshëm e të shokut Enver Hoxha, është zhvilluar në mënyrë të organizuar dhe sipas një plani të menduar e të ndërgjegjshëm. Kjo ka bërë që lufta jonë të zhvillohej drejt, që operacionet e saj luftarake të përfundonin me sukses, që populli ynë, me forcat e veta, të çlironin vendin dhe të vazhdonin luftën kundër pushtuesve nazistë edhe në Jugosllavi.

Partia dhe shoku Enver, tha pastaj shoku Ramiz Alia, qysh në kohën e luftës i dhanë popullit Pushtetin e tij, nëpërmjet këshillave nacionalçlirimtare. Dalja e popullit në krye të vendit, krijimi i Pushtetit Popullor, shënon kurorëzimin me sukses të revolucionit. Dhe në qoftë se në krye të vendit është populli, kjo i detyrohet në mënyrë të veçantë qartësisë ideopolitike të shokut Enver, që ka ditur të demaskojë planet e armiqve, që u ka re-

zistuar dhe ka hedhur poshtë me vendosmëri veprimet e oportunistëve dhe komplotet e armiqve të tjerë.

Shoku Enver Hoxha është arkitekti i Shqipërisë së re socialiste. Atij i takon merita kryesore në përpunimin e programit të ndërtimit socialist, që e nxorri vendin nga errësira në dritë, që krijoi kushtet që jeta e popullit punonjë të përmirësohej pandërprerë.

Programi që hartoi Partia, tha pastaj shoku Ramiz Alia, me në krye shokun Enver, për ndërtimin e socializmit ishte një zbatim krijues i mësimave të marksizëm-leninizmit. Kur hedhim sytë prapa dhe shohim rrugën e përshkuar, sukseset e fitoret madhështore që janë arritur bëhet edhe më e qartë se ç'fuqi të madhe krijuese kishin ato zgjidhje që u dhanë Partia dhe shoku Enver problemeve që dilnin. Në këto katër dekada, tha pastaj shoku Ramiz Alia, të jetës sonë të lirë, Shqipëria ka kaluar disa revolucione, që ne i quajmë transformime revolucionare, siç janë ato në fushën e ekonomisë, të kulturës, të ideologjisë etj. Në secilin fushë në themel të luftës së Partisë, të klasës punëtore dhe masave të tjera punonjëse kanë qëndruar dhe qëndrojnë orientimet programatike të shokut Enver, mësimet e tij marksiste-leniniste, që i janë përgjigjur realitetit shqiptar dhe kërkesave të zhvillimit tonë. Nën udhëheqjen e Partisë, me shokun Enver Hoxha në krye, brenda një kohe të shkurtër vendi ynë ka ndryshuar plotësisht pamjen e vet, ai është shndërruar në një vend të përparuar, me industri dhe bujqësi shumëdegëshe e moderne, të afta për të përballuar në një nivel gjithnjë e më të lartë nevojat e popullit.

Te ne, tha shoku Ramiz Alia, është bërë një revolucion i thellë ideologjik e kulturor. Shoku Enver është frymëzuesi dhe luftëtari më aktiv i këtij revolucion. Me nxitjen dhe kujdesin e tij të drejtpërdrejtë u zhvillua arsimi i të gjitha shkallëve, u krijua arsimi i lartë, ku përgatiten tërë kuadrot e nevojshme për përparimin e të gjithë sektorëve. Aktualisht, vendi ynë është në gjendje të ecë në një hap me progresin teknik e shkencor të kohës pa patur nevojë për specialistë të huaj.

Kushdo në vendin tonë është dëshmitar i impulsit që mori ndërtimi socialist dhe përparimi i vendit pas lëvizjeve të frymëzuara nga shoku Enver, si rrjedhim i të cilave u shembën kanunet që skllavëronin gruan, u flakën tej prangat e fesë dhe zakonet e vjetra.

Emri i shokut Enver lidhet ngushtë me aktivitetin ndërkombëtar të Shqipërisë socialiste, tha pastaj shoku Ramiz Alia. Ai ka përpunuar dhe udhëhequr politikën e jashtme të vendit tonë, një politikë revolucionare, që i ka siguruar Atdheut një prestigj dhe autoritet të veçantë. Kjo politikë është politikë e pavarësisë së plotë dhe e sovranitetit të pakufizuar, një politikë armike e imperializmit amerikan dhe e socialimperializmit sovjetik, armike e reaksionit botëror dhe përkrahëse e vendosur e popujve dhe e forcave revolucionare kudo në botë.

Shoku Enver ka mbajtur lart flamurin e marksizëm-leninizmit dhe e ka edukuar Partinë tonë që të jetë luftëtare e paepur për mbrojtjen e pastërtisë së tij. Lufta kundër revizionizmit titist, hrushovian, kinëz etj., që përbën një nga meritat e mëdha të Partisë sonë në plan kombëtar e atë ndërkombëtar, një nga provat më të dukshme të besnikërisë së saj ndaj çështjes së marksizëm-leninizmit, ka patur si flamur, si frymëzues dhe udhëheqës luftarak shokun Enver Hoxha.

Shoku Enver Hoxha është një mendimtar i madh marksist-leninist. Tërë vepra e tij teorike është një përgjithësim marksist-leninist i luftës së Partisë, i përpjekjeve të popullit, i rrugës që kanë përshkuar komunistët shqiptarë në luftërat për lirinë e Atdheut dhe ndërtimin socialist të vendit.

Me veprën e vet revolucionare, me gjithçka që ai ka bërë për popullin e Atdheut, shoku Enver ka fituar dashurinë, respektin e tërë popullit shqiptar, të punëtorëve e të fshatarëve, të grave e të rinisë, të intelektualëve e të ushtarakëve. Kjo dashuri është shprehje e mirënjohjes që ndjen çdo shqiptar për njeriun që gjithë jetën e vet ia kushtoi popullit, lumturisë dhe mirëqenies së tij. Shoku Enver është shok e vëlla për çdo shqiptar, sepse secili jetën e tij, gëzimet që ka, të sotmen dhe të ardhmen i sheh të lidhura ngushtë me emrin e Partisë dhe të shokut Enver. Prandaj ai do të rrojë përjetë i dashur, i nderuar dhe i respektuar në zemrat e komunistëve dhe të të gjithë popullit shqiptar. Mirënjohjen dhe respektin tonë për gjithçka ka bërë ai për popullin, për atdheun, për komunizmin do ta shprehim duke ruajtur si sytë e ballit dhe duke çuar akoma më përpara atë veper të shenjtë, Shqipërinë socialiste, të cilës ai i kushtoi tërë jetën, tërë dijet, tërë pathosin e vet revolucionar, tërë dashurinë dhe zemrën e tij të madhe.

Në këtë rrugë, vazhdoi shoku Ramiz Alia, në rrugën e Enverit, ne do të ecim me vendosmëri e pa u lëkundur, sepse ne kemi një Parti të fortë, një Parti që ka në bazë idetë e marksizmit - leninizmit dhe mësimet e shokut Enver. një Parti që mbi çdo gjë vë interesat e socializmit e të Atdheut. Forca e saj qëndron në lidhjet me popullin, në rrënjët e thella që ka në klasën punëtore, në fshatarësinë kooperativiste, në inteligjencën popullore. Ti forcojmë këto lidhje, ti rrisim më tej këto karakteristika, kjo është detyra jonë.

Forca e Partisë është te uniteti i çeliktë i radhëve të saj. Shoku Enver na la një Parti monolite, të pastruar nga armiqtë, nga fraksionistët e deviatorët. Lufta që ka bërë shoku Enver kundër tradhëtarëve të ndryshëm, kundër renegatëve dhe agjentëve të huaj në gjirin e Partisë, që nga Koci Xoxe e Mehmet Shehu me shokë e ka forcuar Partinë, ka rritur shpirtin e saj luftarak. Këtë frymë revolucionare duhet të mbajmë kurdoherë të gjallë, në mënyrë që të zmbarsim me guxim çdo përpjekje të armiqve të klasës, të brendshëm e të jashtëm që do të përpigjen për të çenur sado pak unitetin tonë.

Shoku Enver na mëson se uniteti dhe lidhjet me popullin forcohen duke patur një gjendje të brendshme të shëndoshë, një ekonomi që të ecë përpara me hapa të shpejta e të vendosura. Ne i kemi të gjitha mundësitë materiale e njerëzore që të realizojmë e të tejkalojmë planet që Partia dhe shoku Enver kanë përcaktuar. Le t'i përvishemi punës me forca të shumfishuara ashtu siç na mëson shoku Enver, ashtu siç punonte e luftonte ai.

Duke përfunduar shoku Ramiz Alia tha: Shoku Enver u nda prej nesh. Humbja që pësoi vendi dhe populli është tepër e rëndë dhe e pazëvendësueshme. Por rron Partia krijesë e Enver Hoxhës, rron Shqipëria, të cilën e bëri lule Enveri, rron socializmi, të cilin ai i kushtoi mendjen dhe zemrën, prandaj rron në mes nesh e do të rrojë në shekuj edhe Enveri ynë.

Rroftë vepra dhe kujtimi i shokut, mësuat dhe udhëheqësit tonë Enver Hoxha!

Rroftë Partia jonë e lavdishme e heroike e Punës!

Elegji për Enver Hoxhën

1.

Ish i rëndë dimri i sivjetshëm
Dhe pranvera erdhi me mundim,
Erdhi përmes shirash të rrebeshëm,
Erdhi me një det me hidhërim.

Falmë, Enver, që vargu m'u rëndua,
Falmë, Enver, që fjalët s'i them dot;
Shqipërisë zemra iu lëndua,
Shqipëria Jote po derdh lot.

Shqipëria Jote s'i kish parë
Mbyllur as në gjumë sytë e Tu,
Qielli i ballit Tënd me yj të larë
Ndriti dhe nga retë nuk u zu...

Falmë, Enver, që po përmend në vjershë
Fjalën vdekje mbushur gjëmë e zi,
Fjalën vdekje Ti në varg s'e deshe,
Deshe jetën në çdo poezi.

2.

Malet heshtin, malet ulin kryet,
Roje rrijnë në arkivolin Tënd,
Janë vrenjtur pishat nëpër pyjet,
Po rënkon çdo plis e gur e shkëmb.

Eh, shiriti i zi, një ton me hekur
Më rëndon në krahun tim, Enver,
Shqipëria s'të sheh dot të vdekur,
Ndaj lumenjtë e pikëllimit derdh...

Falmë, Enver, nga dhimbja s'jam i qetë,
Falmë, Enver, që kaq i dobët jam!
Paska çaste kur njeriu i shkretë
Veten s'e pushton e dot s'e mban!

3.

Ti na rrite dhe na bëre burra,
Rrite çdo të ri edhe çdo plak,
Ecëm nëpër male, shkrepë, gurra,
Ndezëm komunizmin prag më prag.

Ne me Ty me dorë i kapëm vjet
Dhe i vumë përmbi Shqipëri;
Ne me Ty s'i ulëm kurrë kryet
Nëpër gjysmëshekullin e ri.

Falmë, Enver, që kryet i kam ulur
Dhe ec rrugës dhe nuk vij në mënd;
Neve, që furtunash jemi turrur,
Çdo qelizë trupi sot na dhëmb!

4.

Vallë a do mësohemi njëherë
Pa të patur pranë dhe mes nesh,
Bora nëpër male kur të bjerë,
Dielli kur të dalë midis resh,

Plisat kur të ngrihen në luginat,
Fushat kur të vishen me flori,
Kur të nisë Komani turbinat,
Kur të mbushet plot liqeni i ri...

Kur të vijnë kongreset e Partisë
Me hap komunizmi ngadhnjmtar,
Dhe të ndritë balli i Shqipërisë
Me flamurin Tënd të ngritur lart...

5.

Falmë, Enver, që frymë dot s'të dhashë
Nga kjo frymë e gjallë e gjoksit tim!
Zemrën time do ta nxirrja jashtë
Të ta jepja Ty me ngazëllim!

C'them dhe unë e ç'vargje hedh në letër!
Fjalët më përziehen, sigurisht!
Vallë a mos jam bërë njeri tjetër?
Dhe harroj që jam një komunist?

Jo, Enveri s'vdiq e s'është i vdekur,
Është i gjallë e ndër të gjallët rron,
Ngrihet sipër malesh kreshtëhekurt
Dhe armatën komuniste çon.

Si profet ngre kokën madhështore
Dhe rrudh ballin mbushur me mendim,
Dhe na thotë: njihni veç fitore,
Pastë nder e dritë vendi im!

Dhe na thotë: ruajeni Partinë,
Që e lindim më dyzetentë,
Jam mes jush, mes brezave që vijnë,
Jam me mendje, frymë dhe me zë!

6.

Falmë, Enver, që jam trishtuar shumë,
Ndofta kam përletur ndonjë varg,
Jam njeri me mish e gjak dhe unë,
Ndonse shoh si komunist aq larg.

Unë e di se zemra Jote e madhe
Di të falë e mua Ti më fal,
Si poet, u preka kësaj radhe
Dhe në gjoks një lësh me lot m'u ndal.

Jam krenar që rrojta me Ty bashkë
Dhe jam bashkëkohës tok me Ti,
Nëpër popull shpirtin Tënd e pashtë,
Pashë pranë të pavdekshmit sy!

Jam krenar që gjendem në armatën,
Që e ke ngritur Ti si arkitekt,
Kjo armatë mprehur e mban shpatën,
Se ia mprehe Ti mbi dyzet vjet...

DRITERO AGOLLI

12 prill 1985

BERAT

NE FJALET E TIJ: E ARDHMJA



Ka 35 vjet që Petraq Vjeshta shpërndan shtypin e Partisë, po kurrrë kjo armë s'i është dukur plumb e rëndë si tani. Këmbët shkojnë e ndalen më parë tek ajo shtëpi e lartë, dalë si nga shkëmbi në Mangalem, që për 37 ditë kishte në gjitë saj Komandantin. Por, nuk që i pari postjeri veteran. Goni Konçe, që e ka shtëpinë aty pranë, lëmon-te me dorë kuvertin e krevatit, tavolinën e punës, shishen e bojës së Tij dhe iu kthye cicerones: «A bën, o bijë ta ndezim këtë llambën e Tij e ta vëmë në penxhere të ndrisë si atëhere? Ah, unë korba, dilja tek muri i avllisë ta shijha a kish fjetur, se që atje duket dhe, llamba ndezur çdo natë, deri në saba. I pagjumi bënte shtetin e ri».

Që kurse ka nisur të shkruhet historia e kohës së Partisë, thuhet se për një kohë Berati ishte kryeqytet i Shqipërisë së re. Dhe nuk që e rastit që, kur shoku Enver deklaronte këtu: «Pushteti që po ngrejme sot nuk është pushtet i rastit, por gjithë e ardhmja e popullit dhe e vendit tonë», në zemrat e në sytë e njerëzve kishte festë. Intuita e pagabueshme e popullit e kishte pranuar e gdhëndur në ndërgjegje si një rrugë logjike Pezën, Labënotin, Përmetin. Dhe nga kjo logjikë do të nxirrte si aksiomë «Po u ndave nga Partia, u ndave nga jeta».

Në zemrat dhe në sytë e njerëzve ka zi. Është një rrënjëqethje deri në gjak, që e shkakton bashkë me lajmin, flamuri i ulur gjysmë shtizë që nga maja e kalasë e nga-

do, heshtja, ai shiriti i zi në anë të portretit vënë në ballë të shtetitorës «Enver Hoxha». «U kam çuar njerëzve mandatin edhe për djalë e vetëm, u kam çuar edhe për nënë e për baba, po kurrë si këtë herë. Edhe pse e kishin dëgjuar në radio lajmin, e rrëmbenin gazetën sikur për të lexuar të kundërtën. Më dhëmb xhani për vete, por dhe për aq dhimbje që kam parë e kam mbledhur», vazhdon postieri i mosshuar.

E rrit peshën e humbjes së madhe çdo kujtim që patjetër është i bukur. Se me Enver Hoxhën s'mund të ishte ndryshe. E rrit vetë jeta e çdo njeri në çdo ditë të 40 viteve të pushtetit të popullit. Janë ata që i besuan më shumë se vetes Atij, në agimin e botës së re se ata, të shtypurit, të përbuzurit e djeshëm do të vendosnin fatin e kombit. Dhe pohojnë me jetën me dinjitet se shoku Enver i udhëhoqi më lart se ëndrrat më të guximshme, ndaj dhe ndarja prej Tij është e pamundshme. Veç një dhimbje kaq e madhe mund të nxirrte dënësën, ashtu si një gulç nga 7 mijë gjokse punëtorësh tekstilliste, në atë shesh ku kanë patur mes tyre aq herë shokun Enver. Drejtoresha e kombinatit, Elvira Dushku, ndërsa i dridhet një lot në sy, hap një bllok të kuq: «Isha në mes të atyre punonjësve që shkuan në shtëpi dhe i uruan 75-vjetorin e lindjes shokut Enver. Dhe isha ulur aq pranë Tij. Ja ç'kam shkruar atje:

«...Më erdhi shumë mirë që er-

dhët për ditëlindjen, që edhe më raportuat. Edhe unë dëshiroj që në gëzimet tua të jem pranë jush. Po unë ju gëzohem nga larg...»

«Jeni, shoku Enver! Gjithmonë, fola si me vete, por shoku Enver më dëgjoi».

«Ashtu, ashtu, me zemër jam...»

Çdo kujtim që rizgohet sjell dhimbje për mijëra naftëtarët e Qyte-tit Stalin, që të mbledhur dje në miting, aty ku shoku Enver vite më parë u fliste: «S'duhet të na zërë gjumi. Jemi të fortë, por mos harrojnë kurrë se akoma ka njerëz që duan të na vënë gurë nën rrota» për kooperativistët e Kutallisë «prodhimet e bollshme arrihen vetëm me vullnetin e papërkulur, me diturinë dhe me zotësinë e njerëzve tanë. Çdo gjë e kemi ne vetë në dorë»; për gurgdhëndësit e vegjël beratas «Rruga ka rëndësi të madhe për të gjithë... Në rrugë njeriu duke ecur dhe mendon, edhe ëndërron për të ardhmen... Jam i bindur se tani që do të vetë t'i shoh, do t'i gjej të forta dhe të bukura dhe, po të jetë vërtet kështu, atëherë do t'ju vë një notë të mirë»; për kooperativistët e Perondisë, ndër më të mirat në rreth, që kështu e mbajnë kokën lart për emrin e nderuar «Enver Hoxha» të kooperativës së tyre. Çdo kujtim rrit edhe forcat, me peshën e një amaneti. Amanetet s'i ka tretur kurrë populli ynë! Në fjalët e shokut Enver është e ardhmja e tij.

NADJA XHEBLATI

POPULLI PER SHOKUN ENVER

Shqipja hesht-i rëndë flamuri

Vjosa, Drini me Valbonën
Kthehen n'lot për Enver Hoxhën
Jo Enver nuk na besohet
Ka e randë dhimbja s'durohet.
Bjeshkt' e nalta ulin kokën
Biejn ng'junj e prekin tokën
S'ndahet kurrë ky komb me Ty
Jo nuk mbyllen ato sy
Zemra më e fortë se guri
Shqipja hesht, i rëndë flamuri.

SALI MANI
Koplik

Bir, o bir të deshmë gjallë

Moj natyra kaq e mirë
Që lind maj e që lind prill

Lule me erë e me shijë
Pse shëmtove bukurinë
E bëre këtë mënyrë...
Ah moj shkencë, a gjëc belanë
Që s'gijete ilaç të rrallë
Bir, o bir, të deshmë gjallë
Enver Hoxha mëndjerrallë.
(Nga ligjërimi në fshatin Golem,
Gjirokastrë, në mitingun e datës
12 prill)

Ktheje forcë këtë gjëmë

Ra zia mbuloi dhenë
U nxi dita u bë sterrë.
Qaj, o popull për Enverë
Qaj për atë trim me vlerë
Sekretarin e Partisë
Komandantin e ushtrisë.
Na bën thirrje Partia
Enveri, zemra e Tij:

«O popull, ngrehu në këmbë
ktheje forcë këtë gjëmë».

AVDUL HAKIU
Kuç

Me flamurin e Enverit

Vdiq Enveri, trimi, burri
Ngjysëm shtize u ul flamuri
Po s'ul kryet jo Shqipnia
Në ballë krenare prin Partia.
O Enver o trim, me fletë
Goja hesht, po zemra flet
Se ti zemrën ke në popull
Nga Korabi gjer në Dropull
Jo nuk luajmë nga istikami
Kët' betim e kem' një zani
Prap do jemi n'rrugën e nderit
Me flamurin e Enverit.

Dibër

PARTI DHE PERSONALITETE SHTETERORE DHE POLITIKE KANE DERGUAR NGUSHELLIME ME RASTIN E VDEKJES SE SHOKUT ENVER HOXHA

Komiteti Qendror të Partisë, Presidiumit të Kuvendit Popullor, Këshillit të Ministrave të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, shokut Ramiz Alia dhe shokut Adil Çarçani, u kanë ardhur telegrame nga parti, kryetarë shtetesh, kryeministra, organizata dhe personalitete të ndryshme politike e shoqërore, në të cilat shprehen ngushëllime me rastin e vdekjes të shokut Enver Hoxha.

Në telegramin dërguar Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, Presidiumit të Kuvendit Popullor dhe Këshillit të Ministrave të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, nga Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Vietnamit, Asamble Kombëtare, Këshilli i Shtetit dhe Këshilli i Ministrave të Republikës Socialiste të Vietnamit thuhet:

Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Vietnamit, Asamble Kombëtare, Këshilli i Shtetit, Këshilli i Ministrave të Republikës Socialiste të Vietnamit, komunistët dhe populli vietnamez u prekën shumë kur mësuan lajmin për vdekjen e shokut Enver Hoxha, Sekretar i Partisë i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, Kryetar i Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik të Shqipërisë, Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

Me vdekjen e shokut Enver Hoxha, Partia, Shteti dhe populli shqiptar humbën një udhëheqës që ia kushtoi tërë jetën e vet çështjes së çlirimit të vendit dhe të ndërtimit të jetës së re të popullit shqiptar. Shoku Enver Hoxha udhëhoqi luftën heroike të popullit shqiptar kundër fashizmit dhe transformimit e thella revolucionare të vendit dhe të shoqërisë.

Shoku Enver Hoxha, si mik i ngushtë dhe i afërt i popullit vietnamez, i ka rezervuar çështjes revolucionare të popullit tonë ndjenjat e përzemërta, përkrahjen dhe ndihmën e çmuar. Ai ka dhënë kontribut të madh për forcimin dhe zhvillimin e miqësisë, të solidaritetit luftarak dhe të bashkëpunimit midis dy vendeve e dy popujve, të Vietnamit dhe të Shqipërisë.

Me dhimbje për shokun Enver Hoxha, ne u dërgojmë Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, Presidiumit të Kuvendit Popullor, Këshillit të Ministrave të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, popullit vëlla shqiptar dhe familjes së shokut Enver Hoxha ngushëllimet tona më të thella.

Partia Komuniste, Qeveria dhe populli vietnamez do të bëjnë çmos për të forcuar dhe për të zhvilluar gjithnjë e më shumë miqësinë dhe solidaritetin vietnamez - shqiptar, mbi bazën e parimeve revolucionare të Marksizëm-Leninizmit.

Ne jemi thellësisht të bindur se Partia dhe Shteti shqiptar me siguri do të realizojnë me sukses të gjitha detyrat për të çuar përpara çështjen e ndërtimit të Shqipërisë, duke arritur sukses të reja akoma më të mëdha.

Në telegramin dërguar Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë nga Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Koresë, thuhet:

Pasi mësuan lajmin e hidhur të vdekjes të shokut Enver Hoxha, Sekretar i Partisë i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, Ju shprehim juve dhe nëpërmjet jush, popullit shqiptar, ngushëllimet tona të thella.

Ju lutemi t'i transmetoni gjithashtu familjes së Tij ngushëllimet tona të sinqerta.

Në telegramin dërguar Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë nga presidenti i Republikës Demokratike të Madagaskarit, Didier Ratsiraka, thuhet:

Populli malgash dhe unë mësuan me hidhërim vdekjen e shokut Enver Hoxha, udhëheqës i madh i Partisë së Punës të Shqipërisë. Jeta e gjatë luftarake e këtij njeriu të madh, do të mbetet përgjithmonë në historinë e luftës antimperialisht dhe për socializmin.

Në emër të pushtetit revolucionar dhe në emrin tim personal, ju lutem pranoni ngushëllimet e sinqerta të popullit malgash.

Me konsideratë të lartë.

Shokut Ramiz Alia i kanë ardhur telegrame nga kryetarë shtetesh:

Në telegramin e presidentit të Republikës së Turqisë, Kenan Evren, thuhet:

Mësoma me emocion të thellë vdekjen e Enver Hoxhës, Sekretar i Partisë i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë. Enver Hoxha, burrë shteti i madh, i vlerësuar nga mbarë bota, punoi vite me radhë për begatinë dhe mirëqenien e vendit të popullit të tij dhe zhvilloi miqësinë turko-shqiptare, për të cilën dha një kontribut tepër të madh.

Në emër të popullit turk dhe në emrin tim personal, dëshiroj t'u shpreh, Presidiumit të Kuvendit Popullor të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, popullit shqiptar si dhe familjes së Tij ngushëllimet e mia më të thella për këtë humbje tragjike.

Në telegramin e presidentit të Republikës Franceze, Fransua Miteran, thuhet:

Me rastin e vdekjes së Zotit Enver Hoxha, Sekretar i Partisë i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, personaliteti i fuqishëm i të cilit ka përcaktuar historinë bashkëkohore të vendit tuaj, ju dërgoj ngushëllimet e mia, si dhe dëshirat

që unë formuloj për marrëdhëniet franko-shqiptare.

Në telegramin e presidentit të Republikës së Finlandës, Mauno Koivisto, thuhet:

Me rastin e vdekjes së Shkëlqesit të Tij, Zotit Enver Hoxha, Sekretar të Partisë së Punës të Shqipërisë, dëshiroj t'i shpreh Shkëlqesitë Suaj ngushëllimet e mia më të sinqerta.

Në telegramin e sekretarit të përgjithshëm të Partisë Komuniste Rumune, president i Republikës Socialiste të Rumanisë, Nikolae Ceausescu, thuhet:

Me keqardhje mësoma lajmin e vdekjes së shokut Enver Hoxha, Sekretar i Partisë i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, Kryetar i Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik të Shqipërisë.

Në emër të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Rumune, të Këshillit të Shtetit të Republikës Socialiste të Rumanisë si dhe në emrin tim personal, ju dërgoj ngushëllimet e sinqerta për humbjen e shokut Enver Hoxha. Ju lutem t'i transmetoni familjes së Tij dhimbjen time të thellë.

Në telegramin dërguar nga presidentja e Republikës së Maltës, Agatha Barbara, thuhet:

Në emër të popullit dhe të Qeverisë së Republikës së Maltës, si dhe në emrin tim, shpreh dhimbjen time të thellë për vdekjen e udhëheqësit tuaj të nderuar dhe të dashur, Enver Hoxha.

Ju lutem i shprehni, gjithashtu, ngushëllimet e mia të sinqerta dhe simpatinë e thellë familjes së Tij për këtë humbje të madhe.

Në telegramin e Kapitenëve Regjentë Enco Kolombini e Severino Tura dhe nga sekretari i Shtetit për Punët e Jashtme të Republikës së San Marinos, Xhordano Bruna Refi, thuhet:

Në emër të Qeverisë, të popullit të Republikës së San Marinos dhe në emrin tonë personal, i lutemi Shkëlqesitë Suaj të pranojë ndjenjat e dhimbjes të sinqertë për humbjen e Sekretarit të Partisë së Punës të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, Enver Hoxha dhe ngushëllimet tona që formulojmë me miqësi për popullin shqiptar.

Shokut Adil Çarçani i kanë ardhur telegrame nga kryetarë qeverish:

Në telegramin e kryeministrit të Greqisë Andreas Papandreu, thuhet:

Me hidhërim të thellë mësoma për vdekjen e Enver Hoxhës, Sekretarit të Partisë së Punës të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, e cila është një humbje e madhe për vendin tuaj.

Ju lutem pranoni ngushëllimet e mia të sinqerta.

Në telegramin e kryetarit të Këshillit të Ministrave të Italisë, Bettino Craxi, thuhet:

Dëshiroj t'u shpreh ngushëllimet e Qeverisë Italiane dhe të miat personale për humbjen e Sekretarit të Partisë së Punës të Shqipërisë, Enver Hoxha, protagonist kryesor i historisë së re të vendit të tij.

Në këto çaste hidhërimi për Kombin Shqiptar, dëshiroj t'u shpreh ndjenjat e solidaritetit dhe të miqësisë së ripërtërirë të Qeverisë Italiane, i sigurtë se edhe në të ardhmen marrëdhëniet ndërmjet Italisë e Shqipërisë - fatmirësisht të forcuar këto vitet e fundit - do të vazhdojnë të zhvillohen në mënyrë të frutshme në interes të dy palëve dhe në respektimin e plotë reciprok.

Në telegramin e dërguar nga kryeministri i qeverisë së Turqisë, Turgut Ozal, thuhet:

Mësoma me emocion të thellë vdekjen e Enver Hoxhës, Sekretar i Partisë i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë. Ai ishte një burrë shteti i madh, që punoi për begatinë e vendit e të popullit të tij. Në sajë të kontributit të tij të çmuar, marrëdhëniet turko-shqiptare kanë shënuar përparime të mëdha.

Në emër të qeverisë sime si dhe në emrin tim personal dëshiroj t'u shpreh, Shkëlqesitë Suaj, anëtarëve të qeverisë suaj si dhe familjes së Enver Hoxhës, ngushëllimet e mia më të thella për këtë humbje të dhimbshme.

Në telegramin e dërguar nga kryeministri i Republikës Franceze, Loren Fabius, thuhet:

Mësoma vdekjen e Zotit Enver Hoxha, Sekretar i Partisë së Punës të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë.

Në emër të Qeverisë franceze dhe në emrin tim personal, dëshiroj t'u shpreh ngushëllimet e mia shumë të sinqerta.

Në telegramin e kryetarit të Këshillit Administrativ të Republikës Popullore Demokratike të Koresë, Kang Song San, thuhet:

Duke mësuar lajmin e hidhur për vdekjen e shokut Enver Hoxha, Sekretar i Partisë së Punës të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, ju shpreh ngushëllimet e mia të thella juve, dhe nëpërmjet jush, pjesëtarëve të familjes së Tij.

Në telegramin e kryeministrit të Republikës së Maltës, Karmenu Mifsud Benici, thuhet:

Në emër të Qeverisë së Republikës së Maltës dëshiroj t'i shpreh Shkëlqesitë Suaj, si dhe Qeverisë e popullit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, ngushëllimet më të thella e të sinqerta për humbjen e hidhur të udhëheqësit tuaj, Enver Hoxha.

Ju lutem, Shkëlqesi, kini mirësinë, t'ia transmetoni këto ngushëllime familjes së Tij.

Në qendra pune e prodhimi, në fshatra, institucione e reparte ushtarake të rrethit të Lezhës, po organizohen mitingje, ku pjesëmarrësit shprehin dhimbjen e thellë për vdekjen e shokut Enver Hoxha dhe njëkohësisht betohen se do ta shpëjnë akoma më përpara veprën e ndritur e të pavdekshme të Tij.

Në një miting të tillë u mbledhën nënësisht e mësuesit e shkollës së mesme ekonomiko-bujqësore të qytetit të Lezhës, ku foli sekretari i parë i Komitetit të Partisë të rrethit Mentor Muço.

Në Prigonat të rrethit të Tepelenës, u mbledhën anëtarët e kooperativës bujqësore «Xheladin Beqiri». Për figurën e ndritur të Udhëheqësit tonë të shtrëngjit, për cilësinë e tij si marksist-leninist konsekuent dhe patriot i devotshëm, foli sekretari i parë i Komitetit të Partisë të rrethit Manxhar Binaj.

Mijëra naftëtarë dhe punonjës të tjerë të qytetit të Patosit në rrethin e Fierit, me pikëllim të thellë u mbledhën dhe në një miting që u organizua në sheshin kryesor për të nderuar veprën dhe kujtimin e shokut Enver Hoxha.

Për rolin e shokut Enver si udhëheqës i shquar i Partisë dhe i popullit, që gjithë jetën dhe energjitë e tij ia kushtoi çështjes së Partisë, të popullit e të socializmit, foli sekretari i Komitetit të Partisë të rrethit Tajar Hysi.

(ATSH)

Mbrojtës i vendosur i marksizëm-leninizmit dhe i pavarësisë së Shqipërisë

- Shtypi botëror mbi jetën dhe veprën e shokut Enver Hoxha -

Agjenci të shumta lajmesh, stacione radios dhe gazeta të vendeve të ndryshme kanë dhënë vazhdimisht këto ditë njoftime e komente lidhur me vdekjen e Udhëheqësit të dashur të Partisë e të popullit tonë, shokut Enver Hoxha. Ato kanë transmetuar pjesë të gjëra të dokumenteve të Partisë dhe njoftimeve të Agjencisë Telegrafike Shqiptare lidhur me vdekjen e shokut Enver Hoxha. Vëmendja është tërhequr në ato pjesë ku është theksuar se «jeta dhe vepra e shokut Enver Hoxha është historia e gjallë e Shqipërisë së sotme», se «në të gjitha momentet kyçe kur zgjidhej rruga që duhej ndjekur dhe lufta që duhej zhvilluar, udhëheqja dhe drejtimi i tij kanë qenë vendimtarë», se «ishite Ai në krye të Partisë që në përpjekje të ashpër me armiqët e jashtëm e të brendshëm, me oportunistët e fraksionistët, hartoi dhe përpunoi vijën e përgjithshme politike të Luftës Nacionalçlirimtare, që gjeti dhe përcaktoi rrugët për të arritur në fitoren e 29 nëntorit të vitit 1944».

Shtypi i huaj ndalet gjithashtu në pjesët e njoftimit të Komitetit Qendror të Partisë ku vihet në dukje se shoku Enver Hoxha «ka përpunuar vijën e përgjithshme të politikës së jashtme dhe qëndrimet e Partisë e të shtetit tonë për çështjet ndërkombëtare», duke theksuar se kjo politikë është karakterizuar nga «kundërshtimi i vendosur ndaj imperializmit amerikan, socialimperializmit sovjetik dhe reaksionit botëror», se «nën udhëheqjen e shokut Enver Hoxha Partia e Punës e Shqipërisë ka zhvilluar një luftë heroike kundër revizionizmit modern, se shoku Enver Hoxha ishte një «internacionalist i vërtetë».

Sipas njoftimeve të radios «Zëri i Turqisë», «shtypi turk i datës 12 prill i kushtoi një vend të gjërë vdekjes së udhëheqësit të shquar të Shqipërisë, Enver Hoxha». Gazetat më të mëdha të Turqisë botuan lajme, komente e materiale të tjera. Një artikull i botuar në gazetën «Hyriet» thekson midis të tjerash: «Shqipëria humbi udhëheqësin e saj më të madh e të lavdishëm Enver Hoxha, i cili ka udhëhequr vendin që nga mbarimi i luftës çlirimtare, gjatë gjithë jetës së tij nuk bëri as lëshimin më të vogël lidhur me pavarësinë e vendit. Shqipëria është sot vendi i vetëm në botë i cili nuk i ka bërë asnjë lloj lëvizjeje vendi dhe i cili mbështetet në forcën e veta. Shqipëria e Enver Hoxhës nuk është përzier në punët e brendshme të asnjë vendi dhe ka vendosur marrëdhëniet miqësore me të gjitha vendet që i kanë shtrirë dorën e miqësisë. Ndërsa gazeta «Gynajden» thekson se «Enver Hoxha ishte një udhëheqës, të cilin e donte pa masë populli shqiptar».

Agjencia MENA bën të ditur se gazetat egjiptiane «Al Ahram» dhe «Al Akhbar» të 12 prillit botuan në faqet e tyre të para njoftimin për vdekjen e shokut Enver Hoxha, të shoqëruar edhe me fotografinë e tij. Programet e lajmeve të radios e televizionit egjiptian pasditen e 11 prillit dhanë në të gjitha emisionet e tyre si lajm kryesor njoftimin për vdekjen e shokut Enver Hoxha. Programet e televizionit shoqëroshin edhe me pamje filmash dokumentarë nga takimet e shokut Enver Hoxha me popullin.

Agjencia austriake e shtypit, APA, nënvizon sidomos ato pjesë ku vihet në dukje se Enver Hoxha është «figura më e madhe historike e Shqipërisë» dhe emri i tij «është i lidhur me të gjitha betejat klasore dhe me të gjitha fitoret e Partisë e të popullit shqiptar». «Askush, cion kjo agjenci, nuk ka mbrojtur me aq pathos revolucionar, në çdo

kohë e në çdo situatë, mësimet e Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinin nga shtrëmbërimet oportuniste, askush si ai nuk ka demaskuar politikën dhe veprimtarinë socialimperialiste e socialshoviniste të titistëve, hrushovianëve e renegatëve të tjerë».

Në njoftimet dhe komentet e dhëna nga agjencia Frans Pres theksohet se «Enver Hoxha qëndroi për më se 40 vjet pa bërë lëshime në krye të një partie, që njihet për qëndrimin e vendosur në fushat ideologjike, ekonomike e sociale». Në to vihet në dukje se «ai ishte në moshën 33-vjeçare kur themeloi Partinë Komuniste Shqiptare, në nëntor të vitit 1941, në një kohë kur vendi ishte pushtuar nga Italia dhe pak vjet më vonë e bëri vendin Republikë Popullore të pavarur». «Ai mundi ta shpëpusë Shqipërinë, dikur vendi më i varfër në Evropë, nga vitet e mesjetës, duke ndërtuar industrinë e rëndës. Përmenden me këtë rast «përpjekjet e shkëlqyera që janë bërë për të shfrytëzuar burimet natyrore, për t'i bërë kodrat pjellore si dhe fushat, për të krijuar degë të reja të industrisë», etj.

«Enver Hoxha ishte mbrojtës i rreptë i marksizëm-leninizmit të pastër dhe të shëndoshë, i vetmi dëshpallur i Stalinin që ka ruajtur komunizmin e vërtetë», vë në dukje agjencia e sipërpërmendur, duke theksuar luftën e gjatë që kanë bërë PPSH dhe shoku Enver Hoxha kundër revizionizmit jugosllav, sovjetik e kinez.

Agjencia ROJTER, vë në dukje, ndër të tjerë, në komentet e saj, se «Enver Hoxha ka qenë në krye të vendit qysh prej çlirimit të tij nga pushtimi nazist, një luftë që u fitua pa ndonjë rol të aleatëve». Ajo thekson se «nën udhëheqjen e tij, shqiptarët krijuan një shtet sovran, të lirë nga dominimi i huaj, gjë kjo e pashembullt në historinë e tyre», dhe më tej thekson: «nën drejtimin e Enver Hoxhës, Shqipëria arriti pavarësinë në fushën ekonomike dhe një nivel bazë të mirëqenies materiale». Ajo është e bërë «një vend ku çmimet ulen në vend që të ngrihen dhe ku nuk ka as kriza energjetike dhe as taksa». «Një interpretues i flaktë i komunizmit. Fjalimet e Enver Hoxhës në të mbushur me fraza plot ngjyra», vë në dukje agjencia e sipërpërmendur, duke përmendur se «ai ka paralajmëruar dikur Moskën dhe Uashingtonin që të mos mendojnë se Shqipëria është një kafshatë që gëlltitet lehtë».

Po kjo agjenci, ndalet më tej në luftën e shokut Enver Hoxha kundër përpjekjeve të udhëheqjes jugosllave «për të gllabëruar Shqipërinë dhe për ta bërë atë një nga republikat e Jugosllavisë», si dhe në kundërshtimin e vendosur të revizionistëve sovjetikë, «që arriti kulmin me fjalimin kurajoz të Enver Hoxhës në një konferencë të 81 partive komuniste në Moskë në nëntor të vitit 1960». «Enver Hoxha, nënvizon kjo agjenci, kundërshtoi me forcë politikën e Hrushovit, i cili donte që Shqipëria të bëhej një koloni për rritjen e frutave dhe t'i shërbente Bashkimit Sovjetik, ashtu sikurse republikat e bananeve të Amerikës Latine u shërbëjnë Shteteve të Bashkuara». «Enver Hoxha, i cili thoshte se shqiptarët më mirë hanë bar se sa të përulen para presioneve apo shantazheve të huaja, e orientoi vendin drejt politikës së mbështetjes në forcat e veta dhe fliste për zhvillimin e lidhjeve me shtetet dashamirëse», vihet në dukje në komentet e ROJTER-it.

(ATSH)

Shqipëria nderon me respekt të thellë kujtimin e shokut Enver Hoxha

(Vijon nga faqja 2)

të e nanatë, veteranë, kooperativistë, të rinj e të reja, pionierë e fatbës nga i gjithë rrethi, që në hesh-tje, me dhimbje të thellë në zemër, mbledhen të dhoma ku lindi shoku Enver, kalojnë në heshtur e me lot në sy pranë fotografive, materialeve e dokumenteve që hedhin dritë për veprën madhështore të Udhëheqësit tonë të shquar.

Në oborrin para shtëpisë organizohet një miting, ku marrin pjesë banorë të kësaj lagjeje, punëtorë të ndërmarrjeve ekonomike, të rinj e të reja të shkollës së mesme «Asim Zeneli» etj. Ndodhje edhe sekretari i Komitetit të Partisë të rrethit Raship Hashorva.

Mbi jetën dhe veprimtarinë e shquar të Udhëheqësit të dashur të Partisë e të popullit tonë shokut Enver Hoxha, foli kryetari i Komitetit Ekzekutiv të KP të rrethit, Nedin Hoxha.

E marrin fjalën pastaj banorë të lagjes «Palorto», mëma që e kanë pritur si djalin e tyre, shokun Enver, kur Ai ka vizituar Gjirrokastërën, flasin shokët e miqtë e tij më të ngushtë, me të cilët ka kaluar fëmijërinë dhe një pjesë të kohës së rinisë. Dhimbja është e madhe, ajo rëndon shumë por njerëzit tanë ja-

në të fortë. Partia dhe shoku Enver i kanë mësuar të kapërcejnë me kurajo çdo dhimbje. Ndaj edhe nëna Fero Hormova thotë:

O Enver do të them dy fjalë: Me Partinë asgjë s'do të na ndajë, grusht çeliku rreth saj gjithmonë do të jemi.

Në Pobrat të rrethit të Beratit, u mbledhën dhe në një miting qindra e qindra banorë të zonës. Për veprën e shokut Enver Hoxha, si mendimtar i madh marksist-leninist, që hartoi e përpunoi programin e transformimeve madhështore dhe të ndërtimit të shoqërisë së re socialiste, si njeriu më i dashur i zemrave shqiptare, foli sekretarja e parë e Komitetit të Partisë të rrethit Mine Guri.

Banorë nga 11 fshatra të kooperativës bujqësore të Dajcit në rrethin e Shkodrës u mbledhën dhe në një miting, ku për jetën dhe veprën e pavdekshme të shokut Enver Hoxha, themeluesit të Partisë, udhëheqësit të shquar të luftës për fitoren e revolucionit popullor dhe krijimin e shtetit të diktaturës së proletariatisht dhe të gjitha arritjeve në rrugën e ndërtimit të socializmit, foli sekretari i parë i Komitetit të Partisë të rrethit Petro Dode.

E morën fjalën pastaj edhe kooperativistë, quadro, kufitarë, etj. të

cilët me fjalë zemre shprehën dhimbjen e madh për vdekjen e udhëheqësit të dashur shokut Enver Hoxha, si dhe vendosmërinë se do të punojnë akoma më shumë për lulëzimin e mëtejshëm të fshatit socialist.

Nga Helmësi historik në Dobrenj, nga Grepcka në Vërzhezhë, si dhe në ndërmarrjet ekonomike të rrethit të Skraparit u organizuan mitingje. Për jetën dhe veprën e shokut Enver Hoxha, për figurën e Tij si Udhëheqës i shquar i Partisë dhe i popullit tonë, banorëve të qytetit të Policanit u foli sekretari i parë i Komitetit të Partisë të rrethit Skënder Kuçi.

Malësorët e rrethit të Pukës, që në këta 40 vjet të pushtetit popullor kanë ndjerë nga afër kujdesin e madh të Partisë e të shokut Enver Hoxha, u hidhëruan pa masë për vdekjen e Udhëheqësit të shquar. Këtë dhimbje e shprehën edhe punëtorët e ndërmarrjeve minerare, që u mbledhën dhe në një miting, ku për jetën dhe veprën e ndritur të shokut Enver, për dashurinë e zjarrtë e mirënjohjen e thellë të malësorëve pukanjës për Udhëheqësin e lavdishëm të Partisë e të popullit tonë, u foli sekretari i parë i Komitetit të Partisë të rrethit Ibrahim Hamza.